



Actellic[®] 50 EC

Lënda vepruese: Pirimiphos methyl
PËRMBAJTJA: Pirimiphos methyl: 50%
Lëndë ndihmëse: 50%
Numri i regjistrimit: AL: 5/2-14.11.2008
KS: 100-0771-11-2007/10.03.2007
Formulimi: Koncentrat i emulsionueshëm

INSEKTICID ME SPEKTËR TË GJERË PËRDORIMI. VEPRON NË MËNYRË TË SHPEJTË NËPËRMJET KONTAKTIT DHE AVUJVE

PËRDORIMI:

FUSHA E PËRDORIMIT	DËMTUESIT	MËNYRA E PËRDORIMIT
Bimët e arave Perime Pemët frutore Ulli, Agrume Hardhi Bimët zbukuruese	Morrat, Vemjet, Tripsat, Tartabiqet, Këpushat Krahëbardhat, Çimkat, Breshkëzat, Pleshtat, Mizat e frutave Milingonat etj.	Përdoret 0,1 - 0,2 litra ACTELLIC 50 EC për dynym. Kur bëhen trajtime tokësore përdoren 50 - 70 litra ujë për dynym. Në rastin e spërkatjeve ajrore përdoren 2 - 3 litra ujë për dynym. Gjatë trajtimit të sigurohet një lagje e mirë e masës vegjetative.
Depo Mjedise industriale Hambare anijesh Vagona trenash etj.	Tenjat Kalandrat Brumbujt Këpushat Miellngrënësit etj.	PËR DEZINFEKTIMIN E MJEDISEVE BOSHE 1- Me spërkatje: Përdoren 500 ml ACTELLIC 50 EC në 15-100 l ujë për 500 m ² . Përdoren volume të mëdha në rastin e sipërfaqeve me aftësi thithëse të madhe. Synohet lagja e mirë e sipërfaqes, por pa filluar të rrjedhi. 2- Me tymosje: përdoren 25 ml ACTELLIC 50 EC në 475 ml vaj të bardhë ose tretës kerosene, për të trajtuar 500 m ² . PËR DEZINFEKTIMIN E PRODUKTEVE 1- Kur produktet (grurë, misër, oriz, bishtajore, fara të ndryshme, miell etj.) janë në thasë, përdoren 50-100 ml ACTELLIC 50 EC në 5 litra ujë për 100 m ² sipërfaqe thesi. Spërkatet dyshemeja dhe sipërfaqja e jashtme e çdo thesi dhe pastaj stivosen. Për efekt më të zgjatur treten 200 ml ACTELLIC 50 EC në 10 l ujë dhe përdoren 50 ml tretësirë/m ² . 2- Kur prodhimi është i derdhur (rifuxho) treten 8-20 ml preparat në 1-2 l ujë për çdo 10 kv prodhim, duke spërkatur në shtresa çdo 50 cm.

- Vërejtje:
1. Mos spërkatni enët dhe sipërfaqet në të cilat përgatiten ushqimet.
 2. Ajrosni ambientet e tymosura përpara se të rifuteni brenda.
 3. Mos spërkatni kur bletët janë në aktivitet.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES: 7 ditë.

FITOTOKSICITETI: ACTELLIC 50 EC nuk është fitotoksik në kulturat dhe dozat e rekomanduara.

PËRZIHET me të gjitha insekticidet dhe fungicidet e njohura me përjashtim të atyreve me reaksion bazik dhe shumë acid.

PERIUDHA E RUAJTJES: 2 vjet

MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin me gojën, sytë dhe lëkurën. -Evitoni thithjen e tretësirës spërkatëse me anë të frymëmarrjes. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë spërkatjes. -Para fillimit të spërkatjes vishni pajisje mbrojtëse. -Lani duart dhe pjesët e pambuluara të trupit para se të hani ose të pini, si dhe pas përfundimit të spërkatjes. -Lani pajisjet mbrojtëse para përdorimit tjetër. -Ruajeni vetëm në ambalazhin fillestar, në vende të sigurta, larg fëmijëve, pijeve dhe ushqimeve për njerëzit dhe kafshët.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me preparatin lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun. -Në rast se gjatë spërkatjes nuk ndjeheni mire dhe në rast gëlltitje mos shkaktoni të vjella, çojeni të aksidentuarin tek mjeku dhe i tregoni atij etiketën. Antidot: Atropina, PAM, TOXOGONIN. Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



I DËMSHËM PËR PESHQIT
Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij. Shkatërroni ambalazhin sipas rregullave në fuqi.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Limited, Guildford,
Surrey GU2 7YH, UK.
Tel: + 44 1438 260 000, Fax: +44 1483 260 001.